



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Senati

Pejë, 23.01.2024

Në bazë të nenit 42, 47, 48, të Statutit të UHZ-së, pas shqyrtimit të raporteve të vetëvlerësimit të njësive akademike lidhur më aplikim për akreditim dhe riakreditim për programe të studimit, Senati në mbledhjen e mbajtur më 22.01.2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Miratohen raportet e vetëvlerësimit të njësive akademike për aplikim të programeve të studimit për akreditim dhe riakreditim;

Fakulteti i Biznesit:

- Menaxhimi i Riskut dhe Sigurimet, MSc
- Menaxhim i Burimeve Njerëzore, MSc

Fakulteti Juridik:

- E Drejta Civile dhe Biznesore, MSc

Fakulteti i Agrobiznesit

- Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit Ushqimor, MSc
- Menaxhim Mjedisë, MSc

Fakulteti i MTHM – së

- Menaxhment dhe Turizëm të Qëndrueshëm, MSc

II. Obligohen dekanët e njësive akademike përkatëse që në koordinim me Prorektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Ngritje të Cilësisë të bëjnë përgatitjet e nevojshme konformë rregullatives përkatëse të UHZ-së dhe standardeve të AKA – së;

III. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi t'i dërgohet:

- Prorektorëve
- U. d Sekretarit të UHZ-së
- Dekanëve të njësive akademike
- Drejtorit për Vlerësimin dhe Sigurimin e Cilësisë
- Zyrës së PR - it
- Arkivit të UHZ-së.



Kryesues i Senatit
Prof. Dr. Armand Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UN-VERZITET "HAXHI ZEKA" PEJE
REKTORATI		
Nr./Bri./No.	224	Nr. i Faq/Br. str./No. pg 2
Data / Datumi / Date. 31 / 01 / 2024		

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Senati

Ref. Nr.

Pejë,

Në bazë të nenit 42, 47, 48 të Statutit të UHZ-së, Rregullores nr. 025/23 për Procedurat Vlerësuese dhe Përzgjedhëse Lidhur më Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik të Rregullt në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, Rregullores për Plotësim Ndryshimin e rregullores nr. 025/23 për Procedurat Vlerësuese dhe Përzgjedhëse Lidhur më Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik të Rregullt në UHZ, ref. nr. 2863/23, të dt. 03.10.2023, pas shqyrtimit të propozimeve të njësive akademike, për shpalljen e konkursit për riemërimin/avancimin e personelit të rregullt akademik, Senati në mbledhjen e mbajtur me 22.01.2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. Për shpalljen e konkursit për riemërimin/avancimin e personelit të rregullt akademik duke u bazuar në kërkesat e njësive akademike për pozitat si më poshtë:

Fakulteti Juridik

Për riemërim/avancim:

- Një mësimdhënës për lëndët: E Drejta Kushtetuese, E Drejta e Punës;
- Një mësimdhënës për lëndët: E Drejta Penale, E Drejta Penale Ndërkombëtare;

Fakulteti MTHM-së

Për riemërim/avancim:

1. Një mësimdhënës për lëndët: Produkti Turistik dhe Menaxhimi i Turizmit dhe Hotelarisë;
2. Një mësimdhënës për lëndët: Ekologjia dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm;

Fakulteti Agrobiznesit

Për riemërim/avancim:

1. Një mësimdhënës për lëndët: Fitopatologji, Mbrojtja e Integruar;
2. Një mësimdhënës për lëndët: Teknologjia e Drithërave, Mbrojtja e Ushqimit;
3. Një mësimdhënës për lëndët: Biokimia, Hyrje në Teknologjinë e të Ushqyerit;
4. Një mësimdhënës për lëndët: Bioteknologjia Ushqimore, Nutricioni;
5. Një mësimdhënës për lëndët: Agrometeorologji; Bazat e Perimtarisë;


6. Një mësimdhënës për lëndët: Proceset Teknologjike të Industrisë Ushqimore, Ushqimi dhe të Ushqyerit e Njeriut;
7. Një asistent për lëndët: Grup lëndësh nga Biologjia;

Fakulteti Arteve

Për riemërim/avancim:

1. Një mësimdhënës për lëndët: Piano Obligative I-II-III-IV-V-VI, Piano I-II-III-IV-V-VI-VII-VIII;
2. Një mësimdhënës për lëndët: Klarinetë (Instrumenti kryesor) I-II-III-IV-V-VI-VII-VIII, Klarinetë (Instrumenti i dytë) I-II-III-IV; Pedagogji e Instrumentit I-II;
3. Një mësimdhënës për lëndët: Flaut (instrumenti kryesor) I-II-III-IV-V-VI-VII-VIII, Pedagogji e Instrumentit I-II, Flaut (instrumenti i dytë) I-II-III-IV;
4. Një mësimdhënës për lëndët: Harmonia I-II-III, Harmoni Bashkëkohore. Këndim Koral I-II-III-IV-V-VI;
5. Një mësimdhënës për lëndët: Njohje Instrumentesh I-II, Folklor I-II; Instrumentariumi i orff-it I-II, Metoda e Hulumtimit Shkencorë;
6. Një mësimdhënës për lëndët: Saksofon (instrumenti kryesor) I-II-III-IV-V-VI-VII-VIII, Pedagogji e Instrumentit I-II, Jazz muzikë I-II;

Kryesues i Senatit
Prof. Dr. Armand Krasniqi



Vendimi t'i dërgohet:

Rektorit, Prorektorëve, U. d. Sekretarit të Përgjithshëm, Dekanëve të Njësive Akadematike të Juridikut, MTHM-s, Agrobiznesit dhe Arteve, Zyrës për mësimdhënie dhe çështje akademike, Zyrës së financave, Zyrës së personelit, Arkivit të UHZ-së.